L I G J
Nr.8255, datë 19.11.1997

PËR NJË PLOTËSIM NË LIGJIN NR.7491, DATË 29.4.1991 "PËR DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 10 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", pas paragrafit të dytë shtohen paragrafet e mëposhtëm:

"Veprimtaria e kundërligjshme e subjekteve private që prek në masë interesat e individëve dhe grupeve sociale, që është në kundërvënie e në dëm të parimeve të ekonomisë së tregut e të politikave ekonomike e financiare kombëtare e ndërkombëtare, që cenon stabilitetin ekonomik e social të vendit, vihet nën kontrollin dhe administrimin e institucioneve publike kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara.

Shkalla e ndërhyrjes, si dhe kompetencat e kontrollit dhe të administrimit të këtyre subjekteve private nga ana e institucioneve të lartpërmendura, përcaktohet me ligj.

Në këto raste shteti ka të drejtë dhe detyrë të disponojë mbi pasurinë e subjekteve private vetëm në mbrojtje të interesave të të dëmtuarave.

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u ankuar në gjykatë kundër masave të kontrollit, të administrimit e të disponimit të pasurisë së tij, si dhe për të kërkuar shpërblimin e plotë të dëmeve të shkaktuara."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1960, datë 20.11.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani